

ABSTRAKTI

Masat edukative përmisuese ndaj të miturve janë masat themelore në kuadrin e masave dhe dënimeve të zbatueshme ndaj të miturve. Me shqiptimin e këtyre masave ushtrohet rehabilitimi, mbrojtja dhe ofrimi i ndihmës ndaj kryesve të mitur të veprave penale në mënyrën më efektive se sa me sanksionet tjera ndaj të miturve. Kjo në të shumtën e rasteve bëhet edhe pa izolimin e tyre nga ambienti i mëparshëm familjar dhe shoqëror. Duke qenë se këto masa janë shumë të rëndësishme në trajtimin e delikuentëve të mitur, janë bërë pjesë e legjislacioneve të shteteve duke përfshirë edhe Kosovën. Prandaj qëllimi i këtij hulumtimi është të analizoj legjislacionin kosovar përkitazi me masat edukative përmirësuese dhe zbatimin e tyre në praktikë. Për të realizuar këtë është analizuar legjislacioni në Kosovë si dhe statistikave të Gjykatës Themelore në Ferizaj. Pas analizimit të këtyre të dhënave kemi arritur në përfundim se Kosova ka miratuar Kodin e Drejtësisë për të Mitur i cili adreson masat edukative përmirësuese ndaj të miturve si dhe mekanizmat kompetentë për zbatimin e tyre. Në mesin e këtyre mekanizmave bëjnë pjesë edhe gjykatat themelore të Kosovës duke përfshirë këtu edhe Gjykatën Themelore në Ferizaj, e cila sipas statistikave të analizuar, gjatë periudhës 2016-2020 ka shqiptuar gjithsej 339 masa edukative përmirësuese. Poashtu kemi konstatuar se delikuentët ndaj të cilëve janë shqiptuar këto masa kanë qenë rreth 40 % të rasteve të moshës 17 vjeç, kurse të gjinisë mashkullore kanë qenë rreth 94% e rasteve, prej mostrës së vendimeve të analizuar të Gjykatës Themelore në Ferizaj. Veprat penale në të cilat janë përfshirë këta kryes kanë qenë : vjedhje, vjedhje të rëndë, lëndim i lehtë trupor, kanosje, lëndim i rëndë trupor, mbajtja dhe posedimi i paautorizuar i narkotikëve, vjedhje e pyllit e të tjera vepra penale.

Fjalët kyçe: i mitur, masat edukative, riedukimi dhe rehabilitimi.